



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHITES
MUNICIPALITY OF SHITIME/ OPSTINA STIMLJE



Zyra e Kryetarit të Komunës

/Kancelarija presednika opstine/mayor's office

Zyra për Informim/ Information Office/ Kancelarija za Informisanje

Procesverbal nga takimi i dytë publik me qytetarë për Raportin e Punës së kryetarit të komunës së Shitimes, Qemajl Aliu, për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025, e mbajtur më 23 dhjetor 2025, në ora 11:00, në Sallën e Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës së Shitimes, dr. Qemajl Aliu, drejtorë komunalë, zyrtarë komunalë dhe qytetarë.

Takimin e hapi shëfja e kabinetit, znj. Anita Kurti: I nderuar komandant i policisë z. Haxhi Behluli, drejtor i QKMF-së doktori Ilaz, kryeinfermiere Mervete, drejtor i QPS-së z. Adem Ramadani, kolegë nga ekzekutivi, bashkëpunëtorë, qytetarë dhe kolegë nga administrata. Faleminderit që ju keni përgjigjur ftesës së kryetarit për të marrë pjesë në këtë prezantim të punës që e kemi bërë gjatë periudhës korrik-dhjetor. Pa e zgjatur shumë po ia kaloj fjalën kryetarit për ta bërë këtë prezantim.

Qemajl Aliu: Përshëndetje për të gjithë, përshëndetje miq, përshëndetje për udhëheqësit e institucioneve, të nderuar qytetarë, asambleistë, kolegë nga administrata, kolegë nga ekzekutivi, përfaqësues i OSBE-së, faleminderit që sot keni ndarë kohën me qenë të pranishëm në këtë thirrje publike për prezantimin e raportit të punëve të gjashtë mujorit të dytë të këtij viti.

E kam për kënaqësi t'i prezantoj punët që kemi kryer në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2025, paraprakisht, pasa se të filloj, unë do të doja të falënderoj gjithë ekzekutivin, prej kryesuesit Adnan

Ademi e deri te secili prej drejtorëve dhe anëtarëve të kabinetit po edhe secilin nga kolegët e administratës dhe udhëheqësit që punojnë në komunën e Shtimes sepse pa mbështetjen e secilit prej jush nuk do të ishin të mundura vlerësimi dhe implementimi i këtyre projekteve.

Atëherë, siç e dini komuna e Shtimes është vlerësuar për herë të parë me 100% transparencë të indeksit të buxhetit në Komunën e Shtimes. Kjo flet shumë për punën llogaridhënëse dhe për punën e drejtë e ligjore që po bëhet në Komunën e Shtimes. Kjo është nga Instituti GAP, instituti GAP është një nga institutet më relevante për matjen e transparencës. Siç e dini për vitin 2025 buxheti ka qenë afër 11.5 milionë euro dhe jemi rrugës, pasi deri më 24 dhejtor bëhen pagesat në thesarin e shtetit, të shkojmë deri në mbi 97% të realizimit të këtij buxheti që është shifër rekorde në gjithë Republikën e Kosovës.

Disa nga punët e mira të përfunduara në këtë gjashtë mujor janë këto:

Përrurimi i çerdhes së re në Godanc në vlerë 418 mijë euro që është një çerdhe me 72 shtretër dhe me 760 metra katrorë, kjo është çerdhja e tretë që është funksionalizuar brenda këtij mandati, dhe jemi poashtu në proces të ndërtimit të çerdhes në Petrovë që do të jetë edhe më e madhe sesa kjo. Gjithashtu, kontrata është nënshkruar dhe pritet fillimi i punimeve të çerdhes së pestë në Carralevë. Rrjedhimisht, me këto çerdhe ne e përmbushim zotimin për 6 çerdhe në secilin cep në komunën tonë. Kur erdhëm në qeverisje, ne i gjetëm rreth 110 fëmijë që ishin në të vetmen çerdhe, e cila është dashur të renovohej nga fillimi, dhe tash e vijnë edukimin parashkollor mbi 250 nxënës, dhe me shtimin e çerdhes së Petrovës dhe Carralevës do të ketë mjaftueshëm hapësirë për secilin fëmijë nga mosha nëntë muajshe deri në fazën parashkollore që është 5 vjet.

Një nga projektet më cilësore, më të mira infrastrukturore që iu kanë bashkangjitur infrastrukturës së komunës së Shtimes, është edhe unaza që lidh rrugën “12 Qershor” me rrugën “Willim Walker” që e kemi përruruar bashkë me kryeministrin z. Albin Kurti në shtatorin që kaloi, projekt që ka kushtuar gjysmë milionë euro, me infrastrukturë modern, trotuar, ndriçim, kanalizim dhe sinjalistikë dhe kanale kulluese. Poashtu, segmenti i dytë i unazës në drejtim të Ferizajt veç ka filluar punën, ku është rruga “Mic Sokoli” e keni parë që po zgjerohet, kodra poshtë varrezave, aty do të fitojë edhe ndërtimi i rrethrotullimit dhe me këtë segment ne e mbylлим unazën në drejtim të Ferizajt.

Një nga projektet më të mira që i ka ndodhur komunës së Shtimes dhe që ka qenë e mirëpritur prej qytetarëve, ju e dini që është rrëzimi i objektit përpara oborrit të komunës. Kemi pasur sfida, kemi pasur peripeci, ju e dini, besa edhe bllokim nga ana e asambleistëve të opozitës, por ia kemi dalë, domethënë ky objekt është rrënuar, secila njësi banesore dhe e lokaleve do të kompensohet nga buxheti i shtetit, dhe në këtë mënyrë është krijuar kjo hapësirë dhe pritjet të fillojë projekti i parkimit nëntokësor në këtë në këtë parcelë, poashtu edhe do të bëhet sheshi mbi sipërfaqen që dikur ka qenë një objekt pothuajse i rrënuar dhe që ka pasë përfunduar pa asnjë banor dhe janë zhvilluar fenomene të pahijshme të ndodhin pikërisht në zemër të qytetit.

Në kuadër të asfaltimit dhe lidhjes në mes të fshatrave të malësisë, vetëm në këtë gjashtëmujor ne kemi arritur të përfundojmë rrugën e Topillës që është mbi 8 kilometra dhe me një vlerë mbi 1.2 milionë euro. Rrugën Petrovë – Reçak, Rancë, poashtu me vlerë mbi 500 mijë euro dhe mbi 5 kilometra si dhe përrurimin e rrugës së Devetakut me gjatësi mbi 3.5 km që ka kushtuar afër 700 mijë euro. Domethënë, vetëm në këto dy vite ne i kemi asfaltu më shumë sesa 20 km rrugë që i lidhin fshatrat e malësisë, dhe në këtë mënyrë po ia rikthejmë baorëve të këtyre viseve të braktisura në mungesë të rrugëve dhe infrastrukturës, poashtu edhe po e hapim mundësinë e zhvillimit ekonomik, agroturizmit dhe fushave tjera.

Disa nga rrugët e tjera që ne i kemi përruru në këtë gjashtë mujor është rruga “Zeqë Zeqiri” që e lidh fshatin Davidovc me fshatin Godanc, është përruru edhe rruga Vojnoc- Tërrn që ka qenë pothuajse jofunksionale. Rivitalizimi i rrugës William Walker pasi ka qenë një rrugë e demoluar prej mauneve të mëdha të kamionëve. Rivitalizimi i rrugës Davidoc – Rashincë mbi 5.5 km në vlerë prej 900 mijë euro. Përrurimi i rrugës në fshatin Gllavicë, tek Zona Ekonomike siç e keni pa, është rrugë që ka kushtuar rreth 800 mijë euro dhe që shumë shpejt do të bëhet zona e re ekonomike prej 38 hektarësh dhe kjo do të jetë rruga që do ta lidhë zonën ekonomike me Shtimen dhe me Ferizajn. Rivitalizimi i rrugës “Tahir Sinani” dhe “Adem Jashari” është në qendër të Shtimes, ia ka kthyer një pamje të denjë qytetit. Poashtu edhe rivitalizimi i rrugës “Hafir Bajrami” në Zborc, në vlerë mbi 160.000 euro.

Kemi investuar në dy palestra sportive: Palestra e shkollës fillore “Bajram Curri” në Petrovë në vlerë mbi 179 mijë euro, është funksionalizuar tërësisht për të gjithë nxënësit e saj. Poashtu palestra sportive e qytetit që ka filluar në vitin 2019 dhe asnjëherë s’është funksionalizuar tërësisht, janë

investuar rreth 500 mijë euro dhe kjo palestër tashmë është plotësisht funksionale për sportistët e komunës sonë.

Kemi ndarë 120 bursa këtë vit. Ju e dini që i kemi gjetë vetëm 24 bursa kur e kemi marrë mandatin dhe këtë vit ne kemi arritur të ndajmë 120 bursa që i kemi rritur për çdo vit gradualisht. Poashtu, rreth 156 nëna lehonë kanë përfitu prej subvencionit që e ndajmë për çdo nënë pas lindjes (vlera totale 24,800 €) si dhe 132 persona janë mbështetur për nevoja shëndetësore në vlerë prej 200 – 500 euro.

70 mijë euro mbështetje ose subvencione janë ndarë për 19 klube sportive në komunën e Shtimes, 25 mijë euro janë ndarë për OJQ-të rinore si dhe janë ndarë 5 mijë euro për mbështetje të librave të rinj të autorëve shtimjanë. Domethënë të tëra këto subvencione kapin një vlerë 100 mijë euro, ndërsa përpara nesh për të gjitha këto është ndarë një vlerë jo më shumë se 25 mijë. Pra, ne e kemi katërfishuar mbështetjen për fushën e kulturës dhe sportit.

Parku i ri në fshatin Gllavicë iu ka bashkangjitur shumë parqeve që janë ndërtu, që janë mbi 12, dhe i rradhës ka qenë i fshatit Gllavicë. Poashtu trotualet e reja në lagjen e Pajtimit dhe fshatrat: Rashincë, Godanc, Zborc e Belinc.

Pesë (5) super projektet në proces, pra projektet e mëdha që po e transformojnë dhe po i japin dimension krejt ndryshe qytetit tonë janë:

Enti Special, në vlerë 12 milion euro ku po bëhet një punë e jashtëzakonshme dhe besoj që brenda dy viteve ky projekt gjigant do të realizohet dhe do të bëhet pra dislokimi në ambientin e ri.

QKMF “Dr. Vezir Bajrami”, me hapësirë 3,000 m² dhe një investim prej 2.4 milionë euro, tashmë struktura formën e ka marrë dhe pritet që gjatë vitit të ardhshëm të kompletohet dhe të fillojë puna në QKMF-në e re.

Objekti i ri i Komunës, 2.5 milionë euro e me 2,500 m² hapësirë, tashmë vetëm fasada e ka marrë formën e vet dhe sipas komunikave që kemi me operatorin, nëse gjithçka shkon mbarë gjatë verës së ardhshme ne do të dalim me administratë në objektin e ri të Komunës.

Projekti madhor i **shtratit të lumit “Shtimjanja”** në vlerë prej 7 milionë euro, në të gjitha segmentet, prej fshatit Mollopolc, Petrovë, Reçak e deri në Vojnoc, po punohet me një dinamikë

të shtuar dhe besoj që në verën e vitit të ardhshëm do të përfundojë. Poashtu do të fillojmë edhe segmenti fundit që na ka mbetur Pjetërshticë-Carralevë dhe Belinc, gjatë pranverës së ardhshme.

Unaza e Madhe e Qytetit është një aset infrastrukturor që po i shtohet komunës së Shtimes. Kjo unazë e lidh fshatin Reçak dhe fshatin Petrovë, dhe del në Belinc. Ju e dini që janë rreth 11 operatorë që mirren me përpunimin e gurit (gurëthyes), dhe diku rreth 500 kamionë të mëdhenj qarkullojnë çdo ditë në rrugën William Walker dhe në rrugën për fshatin Petrovë e Reçak dhe ky ka qenë një zullum i madh edhe i rrugëve, rrezik i madh për banorët e asaj zone, por edhe një ambient me pluhur dhe me zhurmë. Përmes kësaj veprë infrastrukturore që po punohet dhe është duke ecur shumë mirë, që do të kushtojë mbi 4 milionë euro, shumë shpejt, besoj që vitin e ardhshëm, ky do të jetë funksional dhe këto maune do të kalojnë andej dhe do të lehtësohet rruga e fshatit Petrovë e Reçak, e besa edhe një rrugë e qytetit, pasi këtu te shkolla “Emin Duraku” kyqen kamionët dhe e pengojnë trafikun.

Poashtu ju e dini gjendjen e Varrezave të Dëshmorëve që s’ka qenë as për së afërmi ashtu si e meriton kategoria shoqërore që na ka bërë krenarë dhe është themeli i lirisë dhe shtetit që ne e gëzojmë. Janë ndarë 500 mijë euro dhe po punohet me shpejtësi dhe me cilësi. Ne para dy muajve e kemi nisur këtë projekt dhe siç e keni parë aty është duke u punuar një projekt i jashtëzakonshëm dhe i denjë për varrezat e dëshmorëve.

Kemi vazhduar me fazën e dytë të kanaleve kulluese, janë ndërtu mbi 3 km kanale kulluese në këtë fazë dhe kështu do të vazhdojmë edhe me fazat tjera deri në fund të fshatit Vojnoc. Kjo fazë mbulon rreth 25 hektarë tokë bujqësore.

Përmes bashkëpunimit që kemi me Fondin e Efiçencës, një vlerë rreth 862 mijë euro, janë renovuar dhe rikonstruktuar tërësisht 3 shkolla: SHF “Emin Duraku”, SH.F.M.U "Hasan Prishtina" dhe Shkolla e Mesme Profesionale dhe tashmë edhe këto tri shkolla do të kenë infrastrukturë bashkëkohore.

Renovimi i gjimnazit “Naim Frashëri”, siç e dimë që kur është ndërtuar nuk ka pasur ndonjë ndërhyrje, ka qenë në gjendje jo të mirë, ne e kemi izolu vitin e kaluar përmes Fondit të Efiçencës dhe ka kushtuar rreth 270.000 euro, dhe kësaj rradhe i kemi ndarë rreth 800.000euro për një rikonstruktim total të gjimnazit, që edhe ky objekt shkollor t’i ketë kushtet bashkëkohore.

Poashtu në shkollën “Bajram Curri”, filiali në Mollopolc, në bashkëpunim me KFOR-in turk jemi duke bërë një rikonstruktim dhe një renovim total sepse edhe kjo shkollë ka qenë në kushte jo të mira. Gjithashtu te Lagja e Pajtimit vjet e kemi bërë një rikonstruksion total, aty ka qenë shkolla me stufë dhe me thëngjill, d.m.th në kushte mesjetare, janë ndërru dyert dhe dritaret e plastikës, pra edhe kjo shkollë tani ka kushte më të mira.

Ju e mbani mend që diku në fillim të vjeshtës, bashkë me ministren Nagavci e kemi vendosur gurthemelin e palestrës sportive “Hasan Prishtina” që do të kushtojë rreth 500.000 euro. Edhe kjo është një nga shkollat e mëdha që nuk ka pasur palestër sportive, dhe besoj që deri në shtatorin tjetër edhe nxënësit e kësaj shkolle do ta kenë palestrën bashkëkohore.

Në një memorandum bashkë me “Jetimat e Ballkanit”- janë nisur pesë shtëpi për familjet në nevojë.

Ujësjiellësi për të cilin na ka akuzuar shumë opozita, në njërin anë na ka penguar e në anën tjetër na ka akuzuar, ju e dini që në vitin paraprak ne e kemi filluar një projekt për shpimin e puseve në Gllavicë dhe në Rashincë, që sipas ekspertëve të KRU-së do ta zgjidhë komplet problemin me furnizimin me ujë të komunës së Shtimes dhe fshatrave të rrafshit. Këtë vit prapë ka rifilluar në një vlerë prej 247 mijë eurosh, do të shtohen edhe mbi 20 litra për sekondë dhe përmes këtij projekti Shtimja me fshatrat e rrafshit do ta ketë të zgjidhur mbi 95% furnizimin me ujë të pijshëm. Poashtu, para dy javësh është nënshkru kontrata që do të kushtojë mbi 400.000 euro e financuar nga Komuna e Shtimes dhe KRU Prishtina dhe brenda dy ditësh do të fillojmë edhe investimin në fshatin Pjetërshticë për zgjidhjen e çështjes së furnizimit me ujë atje, ku disa furnizime do të jenë edhe për lagje të Carralevës, Belincit dhe Zborcit. Këto dy ndërhyrje që vlera shkon mbi 700.000euro përfundimisht furnizimi me ujë në komunën e Shtimes do të zgjidhet.

Ju e keni parë që dy rrugë që do t'i japin zhvillim qytetit të Shtimes është Rr. “Ohri” dhe Rr. “Hysiqi”. Rr. “Ohri” tashmë ka përfunduar, e lidh rr. “Anton Çetta” me rrugën për te pishat. Është një arterie shumë e rëndësishme që e lidh njërin cep të qytetit me cepin tjetër, ka kushtuar mbi 300 mijë euro dhe është një rrugë me parametra ndërkombëtarë. Poashtu rr. “Hysiqi” që e lidh transitin mes Davidovcit dhe Rashincës është në fazën e fundit të punimeve.

E kemi një memorandum, kontrata është në fazën e nënshkrimit dhe shumë shpejt do të nisë ndërtimi i dy terreneve sportive, fushave të tenisit, një projekt me vlerë 200 mijë euro. Ky është një bashkëpunim mes Komunës dhe Ministrisë së Kulturës.

Poashtu stadiumi i dytë në Shtime po bëhet në Lagjen e Pajtimt, në vlerë mbi 310 mijë euro.

Gjithashtu do të bëhet inventarizimi i Qendrës Rinore apo “Shtëpia e Përshpirtshme” në vlerë 120 mijë euro dhe shumë shpejt presim me e funksionalizu për shoqatat rinore e sportive. E kemi pasur një bashkëpunim me UNDP-në ku përmes një fondi rreth 63 mijë euro, mbi 10 biznese janë përzgjedhur për t’u mbështetur me trajnime profesionale, me pajisje të nevojshme po edhe me këshilla se sit ë bëhet biznes.

30 të rinj dhe të reja i janë bashkuar administratës për një periudhë 6-mujore praktike, duke u angazhuar në sektorë të ndryshë.

Me rastin e vitit jubilar 35-vjetori i Kushtetutës së Kaçanikut (1990), ju e dini që në mesin e atyre deputetëve të nderuar që kanë bërë histori për Kosovën kanë qenë tre bashkëqytetarë tanë dhe ne iu kemi ndarë mirënjohje të veçantë për meritat e tyre në shërbim të kauzës sonë kombëtare z. Nazmi Fejzullahu, z. Muhamet Shabani, z. Basri Bajrami (post-mortem).

Sa i përket jetës kulturore, ju e dini që jeta kulturore është begatu çdo ditë e më shumë. Ansambli i të rinjve “Ilirida” për herë të parë ka marrë pjesë në një festival ndërkombëtar dhe ka qenë në Festivalin e Valleve Popullore në Denizli në Turqi, në mesin e 23 ansambleve nga e gjithë bota ku kanë qenë mbi 720 pjesëmarrësve dhe aty kanë marrë edhe mirënjohje për cilësitë e tyre artistike. Poashtu ansambli “Ilirida” ka organizuar edicionin e dytë të festivalit “Folk Fest” që tash po bëhet tradicional në komunën tonë ku morën pjesë 12 asamble nga të gjitha trojet shqiptare. Në kuadër të kulturës Shtimja ka marrë pjesë në Festivalin Ndërkombëtar të Karikaturës – HiTHi 2025, për të gjithë të apasionuarit e këtij arti të veçantë. Kësaj rradhe për herë kori i qytetit në Shtime organizoi për herë të parë Festivalin për Fëmijë “Zërat Gazmor” me afro 50 fëmijë pjesëmarrës.

Këto pra të nderuar pjesëmarrës ishin disa prej projekteve që u realizuan dhe që janë në realizim e sipër në gjashtë-mujorin e dytë të këtij viti. Ju falnderoj për pjesëmarrje!

Mbledhja përfundoi në ora 12:20

**Lista e pjesëmarrësve në takimin e dytë publik për këtë vit me Kryetarin e
Komunës, Dr. Qemajl Aliu**

Shtime, 23 dhjetor 2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1.	Adem Qemajli	Q.P.S.	Adem Q.
2.	Mahmudije Hazir	— —	M. Hazir
3.	Enes Fazliu	KK SHTIME	Enes
4.	Lulzim Visherella	K-K. SHTIME	Lulzim
5.	Hasan Hasani	K. SHTIME	Hasan
6.	Mustafë Halili	K. K. SHTIME	Mustafë
7.	Zeqer Thobani	K. K. SHTIME	Z. Thobani
8.	Admine Selmani	Zyra për Informim	Admine
9.	Tenta Mustafa	Zyra për Informim	T. Mustafa
10.	Fjolla Zegiri	Zyra Gjendjes civile	Fjolla
11.	Laura Hysiqi	Zyra Gjendjes civile	Laura
12.	Arbena Lami	Zyra Gjendjes civile	Arbena
13.	Zyqeta Kurti	Zyra etahimit nep.	Zyqeta
14.	Hava Kugaxhija	Zyra kurenditkamend	Hava
15.	Olirjana Kadrija Halili	Zyra e Kadastrit	Olirjana
16.	Besa Gjollari-Qemalli	Zyra e Kadastrit	B. Qemalli
17.	Skender Xhauto	DRKP 2KSH	Skender

18.	Mir Fejzullahu	INSPEKTOR	
19.	Lami Jaziri	adhiheqës i alt	
20.	Basri Mëlluhori	Qytetar	
21.	Lulzim Qamili	QYTETAR	
22.	Xherdet Qomili	QYTETAR	
23.	Eden Haxhi	Qytetar	
24.	Besart Vishesella	QYTETAR	
25.	Arjetë Hatiri	DKRS	
26.	Lora Rashiti	Zyra e Tërmimit në Pronë	
27.	Lirije Roshani	Kytorë në Kërkime të Gjykatës	
28.	SHQIPRIM HXSENI	K.U. SHITIM	
29.	MEFAIL MUSTAFA	OSBE	
30.	DEILAZ KADRIJAS	QKMF -	
31.	Mervete Haxhemi	QKMF	
32.	HAXHI BEHULLI	POUJA KOSOVES	
33.	LIRIJE DUGA	PUNTORE	
34.	Behrije Gashi	F. Strehues	
35.	DANIS SADIKU	QYTETAR	
36.	GRITAB ELMU	Asambleist	
37.	IMRI HOXHA	DREKTOR DAP	
38.	Bandhyl Pushiti	DREKTOR OSHP	
39.	BESNIK AHMETI	DREKTOR BF	
40.	Minoza Sullu Berzi	Drektor PSH	

41.	Volon Jonura	D.P.P.	W. Z. J.
42.	Adnan Adeuni	K.K. Sultime	Adnan Adeuni
43.	Uona Hyseni	Z. Informimit	Hyseni
44.			
45.			
46.			
47.			
48.			
49.			
50.			
51.			
52.			
53.			
54.			
55.			
56.			
57.			
58.			
59.			
60.			
61.			
62.			
63.			



